



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

THIRRJE PËR POZICION TË LIRË PUNE

Pozicioni: Përgjegjës Sektori në Sektorin e Vlefshmërisë Ajrore, në Drejtorinë e Standardeve të Fluturimit.

1. Çfarë po kërkojmë ne?

Autoriteti i Aviacionit Civil ka për qëllim rekrutimin e profesionistëve të fushës, bazuar në profesionalizëm dhe meritë.

Në këtë thirrje Autoriteti i Aviacionit Civil kërkon të rekrutojë profesionistë të fushës, me eksperiencë në administratën publike ose/dhe sektorin privat.

2. Detyrat e pozicionit të punës:

- a) Asiston Drejtorin e Standardeve të Fluturimit (DFS) për të zbatuar Rregulloret e kërkuara Operative për Legjislacionin Bazë të Aviacionit dhe ti rishikojë ato sipas nevojës për të mbajtur nivelin e kërkuar të sigurisë operacionale sipas parashikimeve të vlefshmërisë ajrore (AIR) në Shqipëri.
- b) Kryen të gjitha aktivitetet e nevojshme për të asistuar Drejtorin e DFS për zbatimin në Shqipëri të SARPS-ve përkatëse të përfshira në Aneksin 6, Aneksin 7, Aneksin 8, Aneksin 16 dhe Aneksin 19 të ICAO-s si edhe kryen përditësimet e nevojshme.
- c) Publikon Materiale Udhëzuese dhe dokumenta të tjera të nevojshëm të lëshuar nga ICAO dhe/ose EASA, lidhur me AIR në shqipëri si edhe kryen përditësimet e nevojshme.
- d) Prgatit procedura të shkruara për sektorin mbi aktivitet që kryhen në DFS në lidhje me regjistrimin e mjeteve ajrore dhe vlefshmërinë e tyre.
- e) Kontrollon mjetet e nevojshme për mbikëqyrjen efikase dhe efektive të Organizatave të Menaxhimit të Vlefshmërisë Ajrore dhe Organizatave të Miratuara të Mirëmbajtjes sic janë Manuali i Inspektorëve, Listat e Kontrollit, Formularët e Anketimit dhe Format e Auditit dhe i bëjnë ato lehtësisht të disponueshme në Sektor. Kjo duhet të përfshijë mjetet për inspektime efikase, dhe certifikimin fillestar të operatorëve ajror, mbikëqyrjen vjetore të vazhdueshme dhe certifikimin e organizatave të mirëmbajtjes.
- f) Rishikon të gjithë manualët, procedurat e shkruara dhe manualin e lëshuar nga DFS në lidhje me mbikëqyrjen e vlefshmërisë ajrore dhe përditëson sipas nevojave.
- g) Identifikon dhe këshillon Drejtorin e DFS-së mbi materialet udhëzuese/referuese përkatëse, dokumentet, anekset dhe publikimet e tjera të dobishme në lidhje me AIR, të cilat duhet të jenë të disponueshme në DFS.
- h) Siguron mbikëqyrje të vazhdueshme për Organizatat e Menaxhimit të Vlefshmërisë Ajrore dhe Organizatat e Mirëmbajtjes në mënyrë që të sigurohet që ata të ruajnë standardet e kërkuara të

3. Kushtet dhe kërkesat e pozicionit të punës që duhet të plotësojë kandidati

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati janë:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të zotërojë gjuhën shqipe dhe angleze, të shkruar dhe të folur
- c) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- e) Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna nga institucionet publike apo private, ku ka ushtruar profesionin, e cila nuk është shuar sipas legjislacionit përkatës.



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Kërkesat e pozicionit të punës:

- a) **Arsimimi:** Të paktën diplomë të nivelit Bachelor në Aerospace / Aeronautikë/ Inxhinieri (elektronike, mekanike, elektrike, mekatronik).
- b) **Eksperiencia në punë:** Të ketë të paktën 7 vite përvojë pune në profesion(në fushën në të cilën është diplomuar), nga të cilat 5 vite përvojë pune në pozicion drejtues.
- c) **Gjuhë e huaj:** Anglisht Niveli B2 (ose ekuivalente).

4. Dokumentacioni për dorëzim:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip të vënë në dispozicion nga Autoriteti.
- b) Formën e aplikimit të plotësuar në përputhje me dokumentin tip të vënë në dispozicion nga Autoriteti.
- c) Fotokopje të diplomës Bachelor.
- d) Fotokopje e librezës së punës.
- e) Vërtetim i gjendjes shëndetësore.
- f) Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
- g) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës (listë notash, vërtetim nga fakulteti), trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

5. Aftësi të kërkuara:

- a. **Ekspertize teknike:** Aplikon njohuritë teknike për të kryer aktivitetet mbikqyrëse në fushën e tij/saj të ekspertizës.
- b. **Inisiativë:** Identifikon dhe adreson çështjet në mënyrë të pavarur, proactive dhe të vazhdueshme për të arritur objektivat.
- c. **Zgjidhjen e problemeve:** Zgjidh problematikat me nivele të ndryshme kompleksiteti dhe rreziku. Merr vendime në kohën e duhur duke konsideruar detyrat, faktet, objektivat, rreziqet dhe konfliktet.
- d. **Të menduarit në nivel sistemi:** Kupton dhe përcakton se si component të ndryshme ndërveprojnë dhe afektojnë systemin e performancës së rreziqeve në operim (safety).
- e. **Udhëheqja dhe puna në grup:** Bashkëpunon në të gjitha nivelet e organizatës brenda dhe jashtë drejtorisë/sectorit për të promovuar vizionin dhe objektivat. Bën të mundur që stafi në varësi të tij të arrijë këto objektiva.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për edukimin, përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Totali i pikëve për vlerësimi e kandidatëve është **100 pikë** i detajuar si më poshtë:

- Vlerësimi maksimal për dokumentacionin është **40 pikë**;
- Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është **60 pikë**.

Kandidati me rezultatet më të larta(por jo më pak se 70 pikë) shpallet fitues, ndërsa kandidatët që marrin të paktën 70 pikë në vlerësimin e përgjithshëm renditen në listë pritje.



REZULTATET E VLERËSIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE SHPALLJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT

Rezultate e vleresimit të dokumentacionit.

Në datën **10/05/2023**, Autoriteti i Aviacionit Civil do të shpall një faqen e tij zyrtare të internetit, listën e kandidatëve të kualifikuar për intervistë, të cilët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e pozicionit të punës, si dhe vendin dhe datën e zhvillimit të intervistës.

Kandidatët të cilët nuk janë kualifikuar për intervistë mund të kërkojnë informacion me e-mail në adresën zyrtare rekrutime@caa.gov.al , për aryet e moskualifikimit.

Shpallja e rezultatve të konkurimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve (vlerësimi i dokumentacionit dhe intervistës me gojë), Autoriteti i Aviacionit Civil, do të njoftojë individualisht me e-mail çdo kandidat për rezultatin e pikëve.

Kandidatët të cilët nuk janë dakort me rezultatin, kanë të drejtë të paraqesin ankim me e-mail pranë Autoritetit në adresën zyrtare rekrutime@caa.gov.al. Afati i ankimit është **5 ditë** kalendarike nga data e njoftimit individual.

Autoriteti pas përfundimit të afatit të ankimit do të shpallë fituesin në faqen e tij të internetit.

APLIKIMI DHE DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT

Nëse mendoni se plotësoni kriteret e mësipërme Autoriteti i Aviacionit Civil ju fton të aplikoni dhe të dorëzoni dokumentat e kërkuara (të skanuara) në adresën zyrtare rekrutime@caa.gov.al .

Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit shtyhet deri më datë 08.05.2023, ora 12:00 (mesditë).